



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:013051

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06228761

C.nr.342/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Tulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.K. me numër personal nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqësojnë B.K. dhe F.G. të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson zyrtarja ligjore A.A. me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 342.66 €, jashtë seance, me datë 30.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses L.K. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të: *“OBLIGOHET e paditura Komuna që tia kompensoi paditësit pagën jubilarë dhe atë për të punësuarin L.K. që për 20 vite përvojë pune të njëjtës i takon kompensimi për 75 % të pagës bazë, të cilën e realizon në shumë prej 456.89 €, përkatësisht duhet ti kompensohet shuma 342.66 €”.*

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja L.K. nga Prizreni, me datën 13.01.2024, përmes të autorizuarve të saj pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria e Arsimit në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 342.66 €.

Në padi, të autorizuarit e paditëses kanë theksuar se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune në Prizren me mbi 10 vite përvojë pune dhe e njëjta vazhdon ende të punon mirëpo nuk i është kompensuar shpërblimi jubilar. Andaj gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovon në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura, përmes zyrtares ligjore të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses lidhur me kompensimin e pagës jubilarë. E njëjta ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtar i sindikatës. Sipas saj, të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: kontratën e punës me numër të protokollit 176/2019, të datës 26.09.2019; vërtetimin me numër 68/2023, të datës 25.05.2023; lista e pagës me numër EM00057451.

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 399, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja tek e paditura është në marrëdhënie pune që nga data 19.02.2003 dhe vazhdon ende të punon në vendin e punës arsimtare. Po ashtu nuk është kontestuese se e njëjta pranë të paditurës ka gjithsej 20 vite përvojë pune, të arritur me datë 19.02.2023 dhe paga bazë e saj gjatë vitit 2023 është në lartësi prej 588.00 euro..

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet. Paditësja me padinë e saj ka kërkuar kompensimin e 75 % të pagës jubilarë për shkak të arritjes së përvojës së punës prej 20 viteve. Gjykata bazuar në të lartcekurat, përkatësisht vërtetimi me numër 68/2023, të datës 25.05.2023, ka vërtetuar faktin se paditësja ka filluar punën pranë të paditurës me datë 19.02.2003 dhe se e njëjta 20 vite të përvojës së punës i ka arritur me datë 19.02.2023, në kohë kur Kontrata Kolektive e Arsimit e viti 2021 nuk ka qenë në fuqi. Kjo duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, GJ.A-Su. A 214/2023, të datës 09.10.2023, ku në pikën III, përcaktohet që Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e lidhur me datë 22.01.2021, e nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës, si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri me datë 21.11.2022. Në bazë të lartcekurave gjykata konstaton se paditësja në periudhën për të cilën aplikohet Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021,

(22.01.2021-21.11.2022) nuk ka arritur 20 vite të përvojës së punës dhe për këtë arsye kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pabazuar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 dhe nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.342/2024, 30.09.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.